



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: 13.4.2023

Nr: 16

Ora: 15:00

VENDIM

PËR

**PËRDORIMIN E PAJISJES ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT, NË ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 13864, datë 24.10.2022, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", nenit 20, pikat 1, shkronja "ë" dhe 2, shkronja "c", si dhe nenit 22 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

1. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, procesi i votimit dhe numërimit elektronik të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN), në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
4. Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar

Data: 13.4.2023 Nr: 16
Ora: 15:00



"Për përdorimin e pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".